

**GENTIANA SHAHINI**

**GABIMET DREJTSHKRIMORE NË HARTIMET E NXËNËSVE  
TË SHKOLLËS FILLORE DHE TË MESME TË ULËT  
“SELAMI HALLAÇI”**

**Hyrje**

Mendimi se gjuha (standarde) fillon të mësohet që nga klasa e parë, me fillimin e mësimit të leximit e të shkrimit, nuk është i drejtë. Format e ndikimit të organizuar (ose jo sa duhet) të mësimit e të përvetësimit të saj, fillojnë që në moshën më të hershme, në familje ose në çerdhet e fëmijëve. (Kryeziu, 2006) Familja duke i ndihmuar fëmijës në rritje dhe zhvillim të tij, ndikon gjithashtu në mësimin e gjuhës së folur. Sa arrijnë prindërit që fëmijëve të tyre t’ua mësojnë drejt dhe pastër gjuhën letrare, varet nga shumë faktorë, të cilët ndikojnë më nënyrë direkte apo indirekte, si: ngritja intelektuale e prindërve, ndikimi i rrethit në të cilin jetojnë, (mos) përcjellja e mjeteve të informimit, (mos) lexueshmëria e mjaftuar, etj.

Shkolla si institucion edukativ e arsimor është vatër e të mësuarit dhe folurit e drejtë të gjuhës amtare, e cila deri në mbarim të nëntëvjeçares e përqendron vëmendjen në zotërimin e normës gramatikore, drejtshkrimore e leksikore. Njohja e normave, rregullave gramatikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore na mësojnë ta shkruajmë e ta flasim gjuhën tonë letrare drejt e pa gabime. Duke u njohur nxënësit me rregullat, format dhe konstruktet e gjuhës shqipe, tipologjinë e saj, si dhe duke shijuar bukurinë e pjesëve nga leximi letrar, fitojnë dashuri ndaj gjuhës amtare, zhvillojnë të menduarit, imagjinatën, etj. Andaj, zbatimi në praktikë i këtyre normave, për shumicën e përdoruesve të gjuhës letrare shqipe, pa përgatitje të thellë paraprake për njohjen e rregullave gramatikore, paraqet ende vështirësi të shumta.

**Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Selami Hallaçi”**

Shkolla fillore “Selami Hallaçi” ndodhet në lagjen “Dardania”, e cila është e banuar nga shumë familje, kryesisht të ardhura nga fshatrat e ndryshme të rrethinës së Gjilanit, të cilat kanë sjellë me vete të folmen e tyre. Edhe martesat e bëra mes burrave dhe grave të vendeve të ndryshme, ka bërë që kjo e folme të ndikohet. Prindërit e nxënësve të kësaj shkolle janë të shtresave të ndryshme socio-intelektuale. Te nxënësit e tillë janë edhe më të theksuara shmangiet gjuhësore, qoftë në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut ose edhe të fjalëformimit. “Zotërimi i normave të gjuhës letrare përbën detyrën kryesore të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. Mosnjohja e thelbit të secilës prej këtyre normave, e lidhjeve të ndërsjella midis tyre dhe e veçantive të punës me çdonjërin

prej tyre, përbën një nga shkaqet e dobësive në zotërimin e gjuhës në shkollë.” (Memushaj, 2012, f. 85)

Objektiv i përgjithshëm i programeve mësimore të gjuhës shqipe është aftësimi i nxënësve për komunikim të suksesshëm. Komunikim i suksesshëm është rezultat i zhvillimit të shkathtësive të komunikimit – të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit. Shkolla dhe mësuesit kanë për detyrë që, në tërë veprimtarinë e tyre, të nxitin nxënësit për të fituar e zotëruar kompetenca gjuhësore, në mënyrë që të krijojnë përvojat e tyre dhe të komunikojnë lirshëm, duke i dhënë kuptim të menduarit, nëpërmjet të folurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim. “Gjuha është e domosdoshme për zhvillimin konjitiv, sepse ajo ofron një mënyrë për të shprehur idetë dhe për të bërë pyetje, për të dhënë kategoritë dhe konceptet e të menduarit, si dhe për të bërë lidhjen midis të shkuarës dhe të ardhmes.” (Wolfolk, 2011, f. 45)

Nxënësit tanë, si tekste bazë për mësimin dhe përvetësimin e rregullave normative gjuhësore, përdorin gramatikat shkollore - normative. Në to, rregullat gjuhësore janë të kodifikuara dhe të njëjta për të gjithë nxënësit. Por, nxënësit nuk janë të njëjtë: as nga aspekti psikofizik, psiko-linguistik, e as socio-linguistik. (Kryeziu, 2006)

Kultivimi i gjuhës në shkollën fillore ka dy periudha gati të ndryshme, edhe për nga mënyra e punës e edhe sa i përket qëllimeve. Prej klasës I-V nxënësit i udhëheq një mësues, i cili duke u mbështetur në planet dhe programet mësimore, përpiqet që nxënësve t’ua mësoj leximin, shkrimin si dhe t’u jap njohuri themelore nga gramatika dhe drejtshkrimi. Ndërkaq, prej klasës VI-IX e tutje është periudha e kalimit në mësimin lëndor, ku në kultivimin dhe në përvetësimin e gjuhës amtare ndikojnë edhe mësimdhënës të lëndëve të tjera, të cilët mjaft shpesh i karakterizon e folmja dialektore, me trajta jonormative, kurse mësimdhënësi i gjuhës mbetet thujtë i vetmuar, në mësimin e drejtë të gjuhës së folur dhe të shkruar.

Nga variantet normative duhet dalluar në mënyrë të prerë trajtat jonormative dhe trajtat e gabuara, të cilat janë në kundërshtim të plotë me strukturën e gjuhës dhe duhen përjashtuar fare nga gjuha standarde. Gjuha standarde e njësuar dhe e normuar bëhet kështu një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit e të kulturës. Me të drejtë shprehet pedagogu dhe gjuhëtari Hasan Mujaj (2004, f. 13), se: “Përmes gjuhës e njoh nivelin e formimit arsimor, kulturor dhe civilizues të individit.” Kujdesi për zotërimin e gjuhës standarde dhe për zbatimin e plotë të normave të saj është bërë sot një pjesë e rëndësishme e jetës kulturore të shoqërisë sonë. “Ndikimi në relacion gjuhë standarde – dialekt, është i dyanshëm, raportet e tyre janë reciproke, gjuha standarde nëpërmjet sistemit arsimor, kurse dialektet nga ana tjetër, përsëri përkrahin dhe ndihmojnë në vendosjen e formave dalluese të shtresimit të gjuhës, gjegjësisht ndihmojnë gjuhën standarde.” (Ibrahimi, 2012, f. 113)

#### **Interpretimi i rezultateve të hulumtimit**

Për hulumtim të mirëfilltë të këtij problemi janë shfrytëzuar mostrat e hartimeve të nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Selami Hallaçi”. Janë përdorur disa metoda: metoda e analizës teorike, metoda përshkruese, metoda

## Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

statistikore dhe metoda krahasuese. Mostra jonë ka përfshirë 50 nxënës të klasave V-IX, respektivisht 12 nxënës të klasave të V-ta, 6 nxënës të klasave të VI-ta, 10 nxënës të klasave të VII-ta, 12 nxënës të klasave të VIII-ta dhe 10 nxënës të klasave të IX-ta. Me qëllim që hulumtimi jonë të jetë reprezentativ, mostra ishte e qëllimshme, e zgjedhur në mënyrë llotarike. Gjithashtu, nxënësve të përfshirë në hulumtim u janë kërkuar të dhënat për shkollimin e të dy prindërve, të cilat janë paraqitur në tabelë.

Tabela nr. 1

Shkolli mi i prindërve	Shkolli m fillore	Shkolli m i mesëm	Shkolli m i lartë	Fakultet	Magjistrat urë	Doktorat urë
Nëna	4.65%	32.56 %	27.91 %	34.88 %	///	///
Babai	///	23.25 %	23.25 %	46.52 %	2.32%	4.65%

Nëse i bëjmë një analizë tabelës së mësipërme do të shohim se pjesa më e madhe e prindërve kanë shkollim superior (34.88% nënat dhe 46.52% baballarët), i cili mund të konsiderohet si faktor ndihmues në kultivimin e drejtë të standardit gjuhësor, por nga pjesa tjetër e prindërve mbetet për tu dëshiruar. Gjatë analizës së hartimeve apo eseve të nxënësve të shkollës në fjalë, janë vërejtur shmangie gjuhësore në disa fjalë, qoftë në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut ose edhe të fjalëformimit. Në vazhdim do të sjellim shembuj të përdorimit të gabuar të fjalëve dhe shprehjeve në klasat V-IX.

### • Klasa e pestë

Te nxënësit e klasës së pestë janë vërejtur gabime drejtshkrimore në përdorim të tepërt të zanores **ë**, ngatërrim të bashkëtingëlloreve **q** dhe **ç**, shkrim jo i drejtë i disa emrave, mospërshtatje të foljeve në kohë, si dhe mospërdorim të drejtë të shenjave të pikësimit. Shikuar nga aspekti përmbajtësor, mendojmë se hartimet janë thurur mirë.

- Gabime në të shkruarit e emrave, sidomos në trajtën e pashquar, emrat e përgjithshëm janë shkruar si të përveçëm, si: **Verë** - verë (stinë), **endrra** - ëndrra, **shkoll** - shkollë, **marrveshje** - marrëveshje, **pranëverës** - pranverës, **dritarën** - dritaren, **gjelbrim** - gjelbërim, **mëngjez** - mëngjes, **njerziti** - njerëzit, **njerzimi** - njerëzimi, **ditlindjen** - ditëlindjen, **zojgjit** - zogjtë, **zoghjet** - zogjtë, **stin** - stinë, **pranver** - pranverë, **helmet** - helmetë, **pjestim** - pjesëtim, **oborr timë** - oborrin tim (rasa kallëzore + përemri pronor).

- Gabime në të shkruarit e mbiemrave, si: **të mdha** - të mëdha, **qmuar** - çmuar, **veqant** - veçantë, **gjelbrime** - gjelbërime, gabime në të shkruarit e përemrave: **gjith kush** - gjithkush, **gjithçka** - gjithçka, përemra pronorë, si: **imë** - im, **timë** - tim.

- Gabime në të shkruarit e foljeve, mospërshtatja e foljeve në kohë, mënyrë, si: **jamë** – jam, **pelqen** – pëlqen, **vazhoj** – vazhdoj, **fillojn** – fillojnë, **rezaton** – rrezaton, **plqen** – pëlqen, **gjelbrohet** – gjelbërohet, **u ndam** – u ndamë, **morra** – mora (koha e kryer e thjeshtë), **ai qëndroj** – ai qëndroi (koha e kryer e thjeshtë), ndajfoljet, si: **nxehët** – nxehtë, **gjithmon** - gjithmonë, lidhëzat, si: **porë** -por, **që** – që, etj. Për ta ilustruar mospërshtatjen e foljeve në kohë, po ju sjellim disa fjali të shkëputura nga disa hartime të nxënësve të kësaj klase.

*Ja pra sot erdhi pranvera. Zbukuroi të gjithë qytetin. Të gjithë sot ishim të gëzuar. Vishemi me rroba më të holla... U gëzova shumë se mësuesin e lavdërojnë gjith kush.*

*Një ditë u zgjova herët në mëngjes, hapa dritaren, shikoja qiellin e Kaltër.*

- **Klasa e gjashtë**

Te nxënësit e klasës së gjashtë janë vërejtur gabime më të vogla drejtshkrimore në krahasim me nxënësit e klasave të pesta, mendimet janë shprehur në fjali më të gjata, e herë - herë të përsëritura. Gabime janë vërejtur në përdorim të shenjave të pikësimit, presja është përdorur vend e pa vend, gabime në shkrimin e emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve, etj.

- Gabime në të shkruarit e emrave: **pranëverës** – pranverës, **veren** – verën, **zogjët** – zogjtë, **qërshori** – qershori, **fëmi** – fëmijë (shumësi), **fëmit** – fëmijët (shumësi i rasës kallëzore), **fëtyra** – fytyra, **katerestika** - karakteristikë, **kënaqësinë** – kënaqësinë, **manitshme** – mahnitshme, **pem** – pemë, shpella e **gadimes** – shpella e Gadimes, **Salla, Prindrit**- prindërit janë shkruar si emra të përveçëm, përdorim i fjalës **shopinga** për emrin *shitore*.

- Gabime në shkrimin e mbiemrit **i bukur**- i bukur, foljeve: **është** – është, **të del**- veta e tretë e mënyrës lidhore bën të dalë (Topalli, 2011), përemrave të pacaktuar: **gjdo** – çdo, **gjith** – gjithë, ndajfoljes **gjithmon** – gjithmonë, etj. Në vazhdim po i sjellim disa fjali:

*1 Qërshori është dita për fëmi. 1 Qërshori për fëmiët është një ditë shumë e veçantë.*

*Ajo ka një park, ka shumë shopinga, lojëra, Salla etj. Stina më që më pëlqen më së shumti është vera. Kur fillon të del dielli nis të qelin lulet shumë ngjyrshë...*

- **Klasa e shtatë**

Te nxënësit e klasës së shtatë janë vërejtur gabime drejtshkrimore sidomos në përdorim të zanores **e** në vend të zanores **ë**, që mund të konsiderohet si shprehje e “të shkruarit në internet”, përdorim vend e pavend i kësaj zanoreje; drejtshkrim jo i drejtë i disa emrave, mospërshtatja në numër dhe gjini; mospërshtatje të foljeve në kohë, trajtë, si dhe mospërdorim të drejtë të shenjave të pikësimit, si: vendosjen e pikës në titull, mospërdorim e presjes në fjalitë e zgjeruara, etj. Shikuar nga aspekti përmbajtjesor, mendojmë se hartimet janë thurur më mirë, në krahasim me dy klasat e mëparshme.

- Gabime në të shkruarit e emrave: **fatkeqsi** – fatkeqësi, **kanceret** – kanceri, **shpindë** – shpinë, **pelerin** – pelerinë, **fëmijët** – fëmijët, **nenë** – nëna, **nevoj** – nevojë, **detyren** – detyrën, **shtatorë** – shtator, **çantatë** – çantat, **montonin** – monotoninë, **karateristikat** – karakteristikat, **oboreve** – oborreve, **historin** –

## Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

historinë, **ekonomin** – ekonominë, **ditve** – ditëve, **qershorë** – qershori, **gezime** – gëzime, **stin** – stinë, ngatërrim i emrave të përgjithshëm me ata të përveçëm dhe e kundërta, si: **Pranverën** – pranverën (stinë), **gjilanit** – Gjilanit (qytet).

- Gabime në të shkruarit e foljeve, mospërshtatja e foljeve në kohë, mënyrë, si: **jamë** – jam, **vdekur** – vdiq, **fillonë** – fillon, **përkeqsohej** – përkeqësohej, **do të arij** – do të arrijë, **ndriçojnë** – ndriçojnë, **mendojë** – mendoj, **egziston** – ekziston, **merte** – merrte, ndajfoljet: **shum** – shumë, **pran** – pranë, **bukurë** – bukur, përemri pronorë **imë** – im, përemri i pacaktuar **gjdo** – çdo (ASHSH, 2002). Në vazhdim po i sjellim disa fjali:

*Ashtu si vitet kaluan mua dhimbjet mu shtuan, zemra po më grisët, nuk e di si **do të jetojnë** më shumë, nuk e paramendoj të ardhmen time pa nënën. Pranvera **nje stin** e bukur dhe me **karateristikat** e veta. Duke ecur dëgjova një shushurimë uji, kur shikova pashë një ujëvarë që ai ujë kishte ngjyrë diamanti, **e kaltër e qelet** që të pushonte sytë.*

*U ktheva prapë brenda dhe u ula **prapë** dritares.*

### • Klasa e tetë

Për dallim nga nxënësit e klasave tjera, hartimet e nxënësve të kësaj klase ishin më përmbajtjesore, me shprehje dhe fjalë me të zgjedhura, me përshkrime më të gjata, çka na bënë të kuptojmë se nxënësit thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë, nëpër vite. Edhe gabimet drejtshkrimore ishin evidente, sidomos është vërejtur mospërdorimin e zanores **ë** në disa raste.

- Gabime në të shkruarit e emrave: **njerzve** – njerëzve, **egziston** – ekziston, **ardhmës** – ardhmes,

**përfekte** – perfekte, **ëndërria** – ëndrra, **kafiteri** – kafeteri, **pëshpritje** – pëshpëritje, **fjal** – fjalë, **kërkes** – kërkesë, **dialoshin** – djaloshin, **bien** – bijën, **darsëm** – dasëm, **këmb** – këmbë, **një fshatë** – një fshat, **përgjiet** – përgjigjet, **her** – herë, **mëshuari** – moshuari, **djaloshë** – djalosh, **përgjesi** – përgjegjës, **një dit** – një ditë, **një kush** – një kusht, përdorim i fjalës **sprinka** për emrin *xixa*, **trashigim tari** – trashëgimtari, **elizabetha** – Elizabeta.

- Gabime në të shkruarit e mbiemrave: **veqantë** – veçantë, **e drejt** – e drejtë, **e djathtë** – e djathtë, **të lart** – të lartë; përemra: **gjithqka** – gjithçka, **kët** – këtë, **qmos** – çmos, **të till** – të tillë, **dishka** – diçka, **qdo** – çdo, **qfarë** – çfarë, **gjith** – gjithë; pasthirrma **faliminderit** – faleminderit.

- Gabime në të shkruarit e foljeve, mospërshtatja e foljeve në kohë, mënyrë, si: **kamë** – kam, **ske** – s'ke, **jamë** – jam, **isht** – ishte, **ndigjoj** – dëgjoj, **të shtojn** – të shtojnë, **u bërë** – u bë, **kan** – kanë, **von** – vonë, **fillojm** – fillojmë, **kuptojm** – kuptojmë, **ndajn** – ndajnë, **qudit** – çudit, **dëshirojm** – dëshirojmë, **dëshirojn** – dëshirojnë, **të lexojm** – të lexojmë, **të luajm** – të luajmë, **të friksuar** – të frikësuar, **të shtojn** – të shtojnë, **të doj** – të dojë, **shijojm** – shijojmë, **mbyllë** – mbyll, **hidherosh** – hidhërosh, **udhëroi** – urdhëroi, **kurorzohej** – kurorëzohej, **përgjiet** – përgjigjet, **ç' do të thot** – çdo të thotë; ndajfoljet: **plot** – plotë, **sotë** – sot, **kurr** – kurrë, **për gjithmon** – përgjithmonë, **kushtu** – kështu, etj. Në vazhdim po i sjellim disa fjali:

*Shum herë si adoleshent që jam, hap televizion dhe shikoj ngjarje të ndryshme. A vallë duhet ta ndigjoj këtë fjalë... Ajo e vetmja që të ndihmon të arrish gjithqka, ajo që kurr nuk eci përpara duke të parë ty mbrapa. Në hyrje të lagjeve mund të gjesh shumë kafiteri e dyqane, e nëse je i huaj e i lodhur, mund të ulesh aty, të pish diqka, e të vëzhgosh me kuriozitet pëshpritjet e njerëzve që kalojnë rrugën me nxitim. Mbreti një dit e thirr djalosin dhe i tha: si e ke emrin(?)*

• **Klasa e nëntë**

Në këtë klasë, hartimet e nxënësve ishin më të dobëta në krahasim me klasat tjera, si në aspektin përmbajtjesorë, ashtu edhe në atë struktural. Edhe gabimet drejtshkrimore ishin evidente, por më të vogla në krahasim me klasat tjera.

- Gabime në të shkruarit e emrave: **piken** – pikën, **jet** – jetë, **bot** – botë, **stin** – stinë, **zogjët** – zogjtë, **freskin** – freskinë, **njerzit** – njerëzit, **mëngjesë** – mëngjes, **torb** – torbë, **gjallërin** – gjallërinë, mbiemra: **shfrytzuar** – shfrytëzuar, **mrekullushme** – mrekullueshme, **mëherëshme** – mëhershme, përemra: **dicka** – diçka, **ton** – tonë, **të gjith** – të gjithë (ASHSHIGJL, 2002, f. 439).

- Gabime në të shkruarit e foljeve: **dergojm** – dërgojmë, **deshirojm** – dëshirojmë, **rrespektojnë** – respektojnë, **quajn** – quajnë, **tregojm** – tregojmë, **egziston** – ekziston, **përgaditen** – përgatiten, **nvaret** – varet; ndajfolje: **asnjëher** – asnjëherë, **mir** – mirë, **shum** – shumë, **kurr** – kurrë, **bashk** – bashkë, **posht** – poshtë, **menxi** - mezi dhe lidhëzës **ndersa** – ndërsa. Në vazhdim po i sjellim disa fjali:

*Të gjithë nxënësit përgaditen të duken sa më bukure të kënaqen sa më shumë në këtë natë. Unë jam në klasë të nëntë dhe menxi qe pe pres 5 qershorin që të më ndodhe edhe mua këto gjëra. Vrapova posht mora një torb dhe ja isha jashtë duke shijuar bukurinë dhe madhështinë e Pranverës. Familjarët tanë që jetojnë jasht vendit ton, kthehen për të bër një pushim të këndshëm me familjet e tyre dhe nën freskin dhe gjallërin e pranverës.*

**Konkluzionet dhe masat për përmirësimin e gjendjes**

Të shkruarit kërkon zotërimin e mjaftë të arritjes më të sofistikuar të mendjes njerëzore - gjuhës. Mundësitë gjuhësore janë kaq të mëdha e të thella, sa që ne asnjëherë nuk arrijmë ta zotërojmë të shkruarit plotësisht dhe përfundimisht, megjithëse mund të vazhdojmë t'i përsosim aftësitë tona gjuhësore. (Kane, 2010) Zbatimi i plotë i normës letrare ia zgjeron gjuhës mundësitë për ta kryer sa më mirë funksionin e saj komunikues në shoqëri. Këto trajta që lindin në gjuhën e folur për arsye të ndryshme, përdoren herë-herë edhe në gjuhën standarde për shkak të njohjes së pamjaftuar të normave të saj.

Gjatë analizës së hartimeve - eseve të nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Selami Hallaçi" janë vërejtur shmangie të ndryshme gjuhësore, qoftë në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut. Nëse bëjmë krahasimin e gabimeve të lëshuara të nxënësve, do të vërejmë se mesatarja e gabimeve tek nxënësit e klasave të pesta ishte 14 gabime, klasat e gjashta 10 gabime, klasat e shtata 8 gabime, klasat e teta 8 gabime dhe tek nxënësit e klasave të nënta mesatarja ishte gjithsej 6 gabime. Bazuar në këto fakte mund të përfundojmë se

## Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

nxënësit zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë gjuhësore nëpër vite dhe kjo reflektohet edhe në të shkruarit e tyre. Shmangiet nga norma letrare vërehen tek emrat, në numër, rasë, gjini, trajtë; te foljet, në kohë, numër, vetë, mënyrë; në disa mbiemra, përemra, ndajfolje dhe lidhëza. Gjatë analizës së hartimeve të nxënësve janë vërejtur përdorim vend e pa vend i zanores ë, diku- diku është përdorur zanorja e në vend të asaj ë, si dhe mosrespektim i shenjave të pikësimit, sidomos pika dhe presja. Andaj, bazuar në rezultatet e interpretuara, për përmirësimin e gjendjes aktuale, janë të nevojshme që të merren disa masa:

- Të rishikohen planet dhe programet mësimore dhe të përfshihen më tepër orë mësimore që kanë të bëjnë me të shkruarit.

- Mësimdhënësit duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi të shkruarit të drejtë të nxënësve, duke përfshirë aktivitetet të cilat lidhen me njësitë mësimore, me qëllim të arritjes së objektivit të paraparë.

- Angazhimi i nxënësve me detyra të shtëpisë luan rol të rëndësishëm në ngritjen dhe kultivimin e drejtë të gjuhë shqipe.

- Leximi librave të ndryshëm, i gazetave, revistave pedagogjike, përcjellja e mjetet të informimit, aplikimi i teknologjisë informative, etj. kanë ndikim në përvetësimin e shkathtësisë së të folurit dhe të shkruarit drejt.

- Të organizohen aktivitete letrare në kuadër të shkollës dhe jashtë saj, duke u nxitur dhe stimuluar nxënësit në përfshirjen e tyre sa më të madhe.

- Edhe prindërit duhet bërë përpjekje që në mjedise familjare dhe shoqërore të flitet dhe kultivohet gjuha letrare.

Andaj, me të drejtë akademik Idriz Ajeti thotë: “Kujdesi për gjuhën, për pasurimin dhe pastrimin e saj duhet të shtohet në të gjitha rrethet kulturore e shoqërore në mënyrë që të luftohen pareshtur shmangiet nga norma letrare.”

### BIBLIOGRAFI

A. Woolfolk (2011). *Psikologji edukimi*, Tiranë: CDE.

ASHSHIGJL (2002). *Fjalori i shqipes së sotme*. Tiranë: Toena.

ASHSHIGJL (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHT, faqe 250.

B. Kryeziu (2006). *Si të flasim dhe si të shkruajmë drejt*. Prishtinë: Libri shkollor, faqe 11-72.

H. Mujaj (2004). *Gjuhësia e tekstit*, Prishtinë: FAIK KONICA.

K. Topalli (2011). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet albanologjike, faqe 809.

M. Ibrahim (2012). *Tema sociolinguistike dhe etimologjike*. Shkup: Interlingua.

R. Memushaj (2012). *Për shqipen standarde I. Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*. Tiranë: INFBOTUES.

Th. Kane (2010). *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë: CDE (në kopertinën-prapa).

